**KËRKESË**
**Nr. 360/12, datë 12.10.2023**

**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në nr. 657, datë 8.10.2014, për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor 'Qukës–Pogradec–Qafa e Plloçës', i ndryshuar".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit "dru frutor", vlerësimi i të cilave është kryer bazuar në udhëzimin nr. 1, datë 5.10.2000, sipas tabelës bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Autoritetin Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 1 109 185 (një milion e njëqind e nëntë mijë e njëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
**Egra Ibrahimi**

LISTA EMËRORE PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "QUKËS–POGRADEC–QAFA E PLLOÇËS", PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VKM-NË NR. 657, DATË 8.10.2014, I NDRYSHUAR

| Nr. | PRONARI | | | | | TË DHËNA (mbi pasurinë sipas ASHK-së) | | | | SHPRONËSIM | VLERA TOTALE (lekë) | SHËNIME |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Emri | Atësia | Mbiemri | Adresa e pasurisë | Rrethi | Indeksi i hartës | Zona kadastrale | Nr. i pasurisë | Lloji i pas. | SIPËRFAQE TOTALE | VLERA LEKË – DRU FRUTORË (DREJTORIA E BUJQËSISË LUSHNJË) | | |
| 1 | ZELIHA<br>BRISILDA<br>ELIVERTA<br>JONIDA | XHEVIT<br>FARI<br>FARI<br>FARI | QOSE<br>HOXHA<br>TOLA<br>QOSE | TREBINJE | POGRADEC | PG-34-114-(50-D) | 3627 | 27/12 | DRU FRUTOR | 1872 | 1109185 | 1109185 | KONFIRMUAR nga ASHK-ja POGRADEC |
| | TOTALI | | | | | | | | | | 1,109,185 | **1,109,185** | |